REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

# VENDIM

**Nr. 286 , datë 2.4.2015**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 40, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 76-108, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 3, e kreut II/A, "Puna në ditët e festave zyrtare dhe të pushimit javor", të vendimit nr.511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Kur festa zyrtare bie në ditët e pushimit javor, dita e hënë është ditë pushimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

NR.PROT.1606
DATË 2.4.2015

KUVENDIT
PRESIDENCËS
GJITHË MINISTRIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**